



R E P U B L I K A E K O S O V Ë S
/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI/ BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr. 89/2009

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshijen juridike te paditeses; nga Fsh Komuna e Mitrovices, te cilen e perfaqson Avokat; sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve; dhe nga Mitrovica Rr. p.n. , baza e kontestit ; Per kthimin e pronesise mbi sendin- te palujtshmerise, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.12.02.2013, jep kete;

A K T G J Y K I M

-DETYROHEN te paditurit dhe nga Mitrovica qe se bashku me paditesen ta shfrytzojne ne menyre te perbashket palujtshmerin- banesen e cila gjendet ne lagjen" " ne Rrugen " nr. 40. ne afatin prej 15 diteve nen kercnimin e egzekutimit te dhunshem.

Secila pale i bart shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesja ne padi si dhe permes te autorizuarit te saje ne seancat e mbajtura ka theksuar se Paditesja ka qen e martuar me tani te ndjerin ka bashkjetuar diku 20 vite. Pas vdekjes se tije si trashigimtar te vetem jane shpall paditesja dhe vajza e tyre sipas Aktvendimit te kesaj gjykate T. Nr. 32/09.

Prej muajt Gusht 2008 te paditurit te cilet jane femije nga martesat e pare e te ndjerit , te cilet poashtu kane jetuar ne banesen e cila eshte objekt i kontestit e kane larguar paditesen dhe vajzen e saje . permes kanosjeve duke iu pamundsuar qe te kthehet ne banese dhe te njejten ta disponoj si pronare legitime. Paditesja dhe vajza per kete arsye i eshte dashur qe perkohsisht te strehohen tek familja e saje ne Fsh.

Paditsaja ju ka bere kerkese te paditurve qe banesen tja lirojne per banim por te njejtit kane refuzuar. Kerkon qe e njejta te kthehet ne kete banese ndersa te paditurit te

largohen nga kjo banese edhe pse e din qe kane te drejt ne kete banese mirepo nuk don me jetu me fjale dhe ngatrresa.

Ne seancen e shqyrtimit kryesor ne fjalen perfundimtare i propozon gjykates qe palet ndergjygjese kete pronesi ta shfrytzojne ne menyre te perbashket pasi qe per kete u pajtuan edhe vete te paditurit.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Te paditurit ne pergjigje te padise dhe kerkespadise se paditeses e kontestuan ne tersi kerkespadin e paditeses sa i perket qe te njejtit te largohen nga atu dhe vetem paditesja te jetoj atu. Nuk eshte aspak e vertet se me dhunc dhe kerconime e kane larguar paditesen nga kjo shtepi. E verteta eshte se i ati yne ka pasur mjaft pasuri mirpo prejse eshte martuar me paditesen nga ter pasuria qe ka pasur i ka mbetur vetem kjo banese kontestuese. Krejt pasurin e tije nen ndikimin e paditeses e ka tjetersuar. Perveq vajzes , babai yne ka pasur edhe 3 djem dhe 3 vajza. Ne fares nuk kemi ditur kur eshte zhvilluar procedura trashigimore deri tani ne kto momente qe tani na njoftoi gjykata. Te gjith kemi jetuar ne kete shtepi deri ne vdekjen e babait edhe tani ne jetojm atu 2- vlezrit e qe eshte i martuar. vet ka shkuar ne gjini te vet dhe ma nuk eshte kthyer. Fata kur te don le te kthehet ne kete shtepi e ka dhomen e vete dhe te vazhdon jeten e saje ne as ateher e as tash nuk e pengojm, mirepo kursesi nuk pajtohem qe ta leshojm krejt kete shtepi sepse thjesht skemi ku te jetojm vetem nese mbetemi rrugeve.

Ne fjalen perfundimtare e kontestojne kerkespadin sa i perket qe te largohen nga banesa kontestuese, ndersa nuk e kontestojne faktin qe paditesja te kthehet dhe te jetoje atu sbashku me te paditurit.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi;, Kontraten mbi shitblerjen Leg.nr. 767/2002 dt. 05.06.2002, Aktvendimin mbi trashigimin te kesaje gjykate T. Nr. 32/2009 dt. 02.04.2009 dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Kontrata mbi shitblerje e sipercekur konstatohet se me dt. 28.05.2002 blersi nga shitsja ka bler banesen tani lendore me qmi te shitblerjes prej 55.000 DM.

Nga aktvendimi mbi trashigimin i kesaj gjykate i sipercekur vertetohet se i ndjeri ish nga Mitrovica ka vdekur me 15. 10.2007 dhe se pasuria trashigimore e tije perbehet nga pasuria e palujtshme- banesa tani lendore dhe se si trashigimtar te vetem ligjor jan shpallur dhe e mitura me nga 1/2.

3.

Ne mese ndergjygesve nuk ishte kontestuese fakti se pase vdekjes se te ndjerit , perveq vajzes .. kan mbetur edhe femijet e tije ;3 -djem dhe 3- vajza., se gjer ne vdekjen e te njejtit kane jetuar sbashku ne banesen lendore edhe te paditurit , se kur eshte ber shqyrtimi i trashigimise nuk kan marr pjese te paditurit e ase femijet tjer perveq dhe se per kete shqyrtim te trashigimis te paditurit nuk kane pasur fare njohuri gjer me ngritjen e kesaj padie dhe se tani kete banese e shfrytzojne te paditurit..

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte gjykata konstatoi se te paditurit ne kuptim te nen. 11.1 si dhe nen. 12 te Ligjit mbi proceduren trashigimore, jane trashigimtar ligjor te trashigimlansit dhe ate trashigimtar te radhes se pare te cilet fare nuk jane thirrur ne trashigim sipas radhes se caktuar me ligj ne kuptim te nen.11.3 te njejtit ligj. Prandaj erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi, ashtu qe paditesja sbashku me te paditurit ta shfrytzojne ne menyre te perbashket kete banese tani lendore, qka nje fakt te ketill nuk e kontestuan as te paditurit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet ne dispoziten e nen. 450 te LPK.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C nr.89/2009 dt. 12.02.2013.

G j y q t a r i,
Ragip Kadriu.

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine e permes kesaje gjykate.

Saktsin e pershkrimit e verteton;